

Trajnim për Këshillat Bashkiak

Sekretari i Këshillit Bashkiak Malësi e Madhe, në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit me projektin Bashki të Forta, ka marrë pjesë në trajnimin e zhvilluar në muajin tetor në Lezhë. Në këtë trajnim morën pjesë këshilltarë bashkiakë nga 5 këshillat e Qarkut Shkodër.

Trajnimi u organizua në kuadër të iniciativës të Ministrisë së Shtetit për Pushtetin Vendor për të mbështetur fuqizimin e kapaciteteve të Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV).

Ky trajnim u zhvillua në bashkëpunim dhe koordinim me Shoqatën për Autonomi Vendore (SHAV), Shkollën Shqiptare për Administratën Publike (ASPA), Shoqatën e Këshillave të Qarqeve (SHKQSH), Projektin Financat Lokale, me mbështetjen e Projektit “Bashki të Forta” (BtF2) i cili financohet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe zbatohet nga Helvetas.

Ky trajnim, si vazhdim i trajnimit përgatitor për këshilltarët e rinj dhe komisionet e këshillave, fokusohet në rritjen e kapaciteteve menaxhuese të drejtuesve të këshillave bashkiakë, të cilët kanë përgjegjësinë kryesore për mbarëvajtjen dhe kryerjen e detyrave ligjore të Këshillit.

Pjesëmarrësve ju ofrua mundësia të marrin **informacione dhe instrumenta praktike** për të përmirësuar punën tuaj në raport me përmbushjen e detyrave, duke u fokusuar në një sërë temash kryesore si: kodi i etikës dhe i sjelljes, aktet që rregullojnë veprimtarinë e brendshme dhe konsultimet me publikun, buxheti i këshillit dhe menaxhimin buxhetor.



Tetor 2024